



Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivered	18.07.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHUK	5266/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.832/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi me Kaltrina Avdullahi-Prenaj -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.832/2023 të datës 07.06.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.832/2023 e datës 07.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve sipas Akt Emërimit me numër të protokollit Nr.86 të datës 21.02.2014 në pozitën e punës "Nëpunës i Pensioneve dhe Beneficioneve" në Zyrën Rajonale në Dragash, në kuadër të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, më datë 07.06.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër të protokollit 4652/2023 më datë 09.06.2023, me pretendimin ankimor për kompensim të pagave jubilarë në vlerë të dy pagave mujore për trembëdhjetë (13) vite të përvojës së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.06.2023, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve. Ndërsa më datë 15.06.2023 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesa e parashtruar nga ankuesi përmes postës më datë 07.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër 4652/2023 më datë 09.06.2023; Kërkesë për pagesë me numër 04/3387 e datës 19.09.2022; Përgjigje në ankesë e datës 15.06.2023; Kërkesë për përgjigje e datës 13.06.2023; Listë e pagave për periudhën kohore 01.10.2023 deri 31.10.2023; Akt Emërimi me numër protokoll Nr.86 të datës 21.02.2014; Listë e pagave për periudhën kohore 01.05.2023 deri 31.05.2023; Vërtetim i datës 14.06.2023; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se organi i punësimit, duhet t'i bëjë pagesën në vlerën e dy (2) pagave jubilarë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se pasi që ka arritur mbi 13 vite të përvojës së punës organi i punësimit duhet të paguaj shpërbimin jubilar në vlerë të dy pagave mujore sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje me datën 15.09.2017, ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre (3) muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes. Po ashtu në baze të Vërtetimit të datës 14.06.2023 të lëshuar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve ankuesi ka filluar punën me date 01.01.2012

andaj edhe gjate kohës sa ka qene ne fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ankuesi nuk e ka plotësuar kushtin gjegjësisht nuk e ka arritur përvojën e punës prej 10 viteve ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, andaj Kolegji konstaton se nuk mund të bëhet kompensimi sipas kësaj marrëveshje dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Ndërsa në lidhje me kërkesën e datës 15.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, për pagesën e shpërblimit jubilar pas arritjes së kohës „*prej dhjetë (10) vjetësh pune*” ashtu siç është përcaktuar saktë me dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë „*Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune*”, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit, konkretisht ne baze te listës se pagave ka konstatuar se ankuesit i është kompensuar shpërblim jubilar pas arritjes së kohës „*prej dhjetë (10) vjetësh pune*” në muajin tetor të vitit 2022 ne vlere prej nëntëdhjetë e shtatë (97) euro, andaj si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit me rastin e kompensimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: “*Nëpunësit civilë, kanë të drejtat si në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)*” si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: “*Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune*”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh faktet e lartëcekura konstatoi që ankuesit i është bërë kompensimi për shpërblimin jubilar me rastin arritjes së kohës „*prej dhjetë (10) vjetësh pune*”, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe për këtë arsye vendosi të refuzoj ankesën si të pabazuar, pasi që kërkesa për pagesën shpërblimin jubilar në vlerë të dy pagave mujore është e bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e cila nuk është në fuqi nga data 01.01.2018.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30)

ditëshi nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.832/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

[Signature]
Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

